

Republika e Kosovës PRISHTINË - PRISTINA
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial
Council

KPK/Nr. 616/2024
Datë: 18 qershor 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, bazuar në nenin 7 paragrafi 1 nën paragrafi II dhe nenit 34 të Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 15 paragrafi 7 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Vendimit KPK/nr.1513/2022 të datës 29 nëntor 2022, Raportit të Panelit Hetimor në rastin AD.nr.03/2022-1 të datës 31 maj 2024, duke rishqyrtuar procedurën disiplinore ndaj prokurorit Armend Hamiti, prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, në seancën e këshillimit dhe votimit mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet Raporti me të gjeturat nga Paneli Hetimor AD.nr. 03/2022-1 të datës 31 maj 2024, në rastin disiplinor të Prokurorit Armend Hamiti, Prokuroria Themelore në Prishtinë;
- II. Vërtetohet se, prokurori Armend Hamiti ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 lidhur me paragrafin 2 nën paragrafi 2.10 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
- III. Prokurorit Armend Hamiti i shqiptohet sanksioni disiplinor, "Vërejtje publike me shkrim", sipas nenit 7 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës, me datë 18 mars 2024, ka pranuar si të themeltë ankesën e Armend Hamiti, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, ka prish Vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK.nr.1513/2022 të datës 29 nëntor 2022 dhe e ka kthyer lëndën në rishqyrtim, për shkak të çështjeve të ngritura si: Ligjshmërinë e vendimit të KPK-së për zëvendësimin e anëtarit të Panelit Hetimor, Ligjshmërinë e ndërprerjes së parashkrimit dhe suspendimit të procedurës disiplinore, Tejkalimin e afatit ligjor për ndërmarrjen e veprimeve hetimore nga ana e Panelit Hetimor, përkatësisht, mandatin e këtij paneli dhe Procedimin e raportit të Panelit Hetimor në KPK.

Gjatë rishqyrtimit, Këshilli Prokurorial i Kosovës, në përputhje me nenin 15 paragrafi 7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mbledhjen e mbajtur me 29 mars 2024, ka marr vendim, për themelimin e Panelit Hetimor për

rishqyrtim të rastit disiplinor AD.nr.03/2022-I, duke i obliguar të zbatojnë detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Po ashtu me datë 08 prill 2024 ka njoftuar Gjykatën Supreme me shkrim si dhe në afat ligjor ka shqyrtuar dhe vendosur për rastin disiplinor bazuar në të gjeturat nga raporti i panelit hetimor.

Me datë 31 maj 2024, Këshilli Prokurorial ka pranuar Raportin AD.nr.03/2022-I, me të cilin, Paneli Hetimor ka ardhur në përfundim se prokurori Armend Hamiti ka vepruar në shkelje të nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 lidhur me paragrafin 2 nën paragrafi 2.10 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, shkelje të detyrave të tij zyrtare si Prokuror, që shprehimisht përcakton rastet kur prokurori përfshihet në sjellje qoftë kur është në detyrë apo privatisht të cilat dëmtojnë reputacionin e prokurorit të shtetit ose që mund të dëmtojnë nderin dhe dinjitetin e prokurorit të shtetit si dhe mund të dëmtojnë besimin e publikut.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 18 qershor 2024, pasi që ka shqyrtuar raportin e dorëzuar nga Paneli Hetimor, ka dëgjuar Raportimin e Kryesueses të Panelit Hetimor e cili ka elaboruar të gjitha faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedurës hetimore. Në seancën disiplinore ka prezantuar edhe subjektin e hetimit disiplinor, prokurori Armend Hamiti i përfaqësuar nga avokati Yll Zekaj, i cili nuk është pajtuar për tu deklaruar rreth rastit duke u thirrur në parashkrimin e rastit disiplinor.

Këshilli Prokurorial i Kosovës pas dëgjimit të Kryesueses së Panelit Hetimor, pretendimeve të subjektit të Hetimit si dhe shqyrtimit, analizimit, krahasimit të provave të cekura në raportin e panelit hetimor, fjalës përfundimtare të Kryesueses së Panelit Hetimor dhe pretendimeve të subjektit të hetimit Armend Hamiti, erdhi në përfundim se, në rastin konkret nuk kemi parashkrim të rastit disiplinor dhe është vërtetuar gjendja faktike sikurse është përshkruar në raportin e Panelit Hetimor. Me datë 21 nëntor 2021, në restorantin [REDAKTUAR] Prishtinë, është vërtetuar fakti i takimit midis subjektit të hetimit dhe një të pandehuri. Me rastin e takimit nuk është inicuar asnjë rast i dëshmitarit bashkëpunues, nuk është njoftuar eprori i subjektit të hetimit lidhur me takimin e mbajtur dhe nuk është përpiluar ndonjë shënim zyrtar apo raport nga ana e subjektit të hetimit, Armend Hamiti.

Me rastin e përfshirjes në shkrimin e publikuar në portalin "Paparaci.com", me titull "Kokë me kokë me kriminelin-lidhjet e prokurorit Armend Hamiti me [REDAKTUAR] dhe pohimi nga prokurori Armend Hamiti se takimi i zhvilluar është publikuar dy ditë para intervistës për Kryeprokuror të Shtetit, sipas Këshillit Prokurorial vërteton faktin se takimi ka qenë i realizuar, sikurse është pranuar edhe nga vetë subjekti i hetimit në deklaratën fillestare të tij. Për më tej, prokurori Hamiti në deklaratën me shkrim ka thënë se, deri tek ky takim ka ardhur me faktin se Drejtori Hetues në IPK, [REDAKTUAR] e ka ftuar në takim me arsyetimin se personi në fjalë mund të shërbej si burim informacioni lidhur me zbulimin e ndonjë veprimtarie kriminale vetëm sa e dëshmon realizimin e takimit për qëllime private.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në rastin konkret vlerëson se, nga fotografia e publikuar rezulton fakti se subjekti i hetimit disiplinor ka pasur kontakt me personin me dosje kriminale. Duke dalë në publik, e që për një ngjarje të tillë faktike është dashur të

informohet eprori apo udhëheqësi i departamentit ku prokurori Hamiti ushtron funksionin apo së paku të evidentohet rasti përmes një shënimi zyrtar gjë që një veprim i tillë nuk është ndërmarr. Prokurori Hamiti nuk ka pasur autorizim dhe nuk ka qenë i ngarkuar me lëndë ku ky person ka qenë i përfshirë, andaj pa menduar për rëndësinë e funksionit që e ushtron ka kontribuar në dështim dhe cenim të integritetit të tij si prokuror.

Po ashtu, nga deklarata me shkrim të drejtorit të Hetimeve në IPK, konfirmohet fakti se Prokurori Hamiti para takimit ka qenë i informuar s[REDACTED] është burim informacioni dhe gjatë bisedës me të njëjtin ka pranuar për të zhvilluar atë takim, duke tejkaluar përgjegjësitë si prokuror. Prokurori Armend Hamiti, ka dëmtuar reputacionit e vet prokurorit dhe sistemit prokurorial në tërësi.


Këshilli Prokurorial i Kosovës vlerëson se, organizimi i takimeve të tilla në publik lidhur me zbulimin e veprimtarive kriminale duke mos u evidentuar rastet e tilla në Prokurori, nga ana e prokurorit Hamiti, në këtë çështje disiplinore i konsumon të gjitha elementet e shkeljes disiplinore për të cilën masa disiplinore si në dispozitiv të këtij vendimi është në përputhje me të gjeturat si në raportin e Panelit Hetimor. Veprimet e subjektit të hetimit cilësohen si ndërhyrje në veprimet procedurale të rregullta e që në rastin konkret kanë dëmtuar rëndë reputacionin e Prokurorisë dhe kanë dëmtuar besimin e publikut në besueshmërinë e sistemit prokurorial duke cenuar kështu vlerat që publiku të besoj në ndjekje të paanshme dhe në vlerat e trajtimit të barabartë të qytetarëve para ligjit.

Andaj, për rastin disiplinor të vërtetuar me shkelje serioze, sanksioni disiplinor "Vërejtje publike me shkrim" është në përputhje me shkeljet e gjetura si në raportin e panelit hetimor. Sanksioni disiplinor do të ketë efekt pozitiv mbi vet prokurorin Armend Hamiti që në të ardhmen të veproj komfor procedurave të rregullta.

Nga sa u tha më lart, Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të vlerësimit të çështjes mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial i Kosovës

Tu dërgohet:

- z. Zejnullah Gashi, Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prishtinë;
- z. Armend Hamiti, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë;
- Njësisë për Panele Hetimore;
- Arkivit të KPK-së.